

Andi Kumanova është Drejtor i Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit. Më parë ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Simulimit dhe Observimit në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Ai ka eksperiencë të gjerë në fushën e analizës së të dhënave, statistikave zyrtare, raportimit financiar, digjitalizimit të shërbimeve, si dhe në ndërtimin e sistemeve statistikore në suport të vendimmarrjeve të bazuar në të dhëna.

Është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Aktuariale pranë Universitetit të Padovës në Itali, në degën Statistikë, Ekonomi dhe Financë për Bizneset, duke ndjekur gjithashtu një periudhë studimore në kuadër të programit Erasmus në Universitetin e Utrecht-it në Holandë.

Ka përvojë profesionale shumëvjeçare në kompani shumëkombëshe si Capgemini Italia, ku ka bashkëpunuar në projekte me institucione financiare ndërkombëtare si Allianz Italia (Trieste), pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Sistemeve dhe Tarifimit, gjatë viteve 2015-2019, si dhe në kompaninë Generali Italia BST (Marcon), gjatë viteve 2019-2020, kryesisht në fushat e transformimit digjital, zhvillimit të produkteve inovative të sigurimeve dhe analizave të avancuara.

Pas rikthimit në Shqipëri në vitin 2020, ka dhënë kontribut të rëndësishëm në sektorin publik, veçanërisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, gjatë viteve 2020-2024, ku ka qenë i përfshirë në projekte kyçe të institucionit si Open Data DPSHTRR, fiskalizimi dhe digjitalizimi i sistemeve, si dhe përmirësimi i raportimeve statistikore institucionale.